



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
TIRANË

Nr. Akti 9/80
Datë 16.06.2020

Nr. 9/80Vendimi
Datë 12.03.2021

VENDIM

"MBI KËRKESËN PËR KONFISKIM PASURIE DHE HEQJE TË SEKUESTROS"

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar e përbërë prej:

Gjyqtare: Sandër SIMONI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Evloinda ADILI**, sot më datë 12.03.2021, në Tiranë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, kërkesat e paraqitura nga :

KERKUES:

Prokuroria e Posaçme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar, e përfaqësuar në gjykim nga prokurori **Behar Dibra**.

OBJEKTI:

Konfiskim të pasurive të shtetasit Altin Hajri e konkretisht kompleksi " Golden Resort" me nr. NUIS K81714503E me adresë Pjezë, zona kadastrale 2978, pasuria nr. 54/24, Durrës, vilë dy-katëshe e ndodhur në Pjezë, Shijak, Durrës, pasuria tokë arë me nr. 54/1 zk. 2978 me sipërfaqe 3280 m katror, pasuria tokë arë me nr. 54/ 8 zk. 2978 me sipërfaqe 561 m katror.

NDAJ SUBJEKTIT:

Altin Hajri, i biri i Bajramit dhe i Hatixhesë, lindur më 23.01.1984, lindur e banues në fshatin Pjezë, Shijak, Durrës, me shtetësi shqiptare, i mbrojtur dhe i përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. Repertori 2331 nr. Koleksioni 1428 datë 18.06.2020, nga Shoqëria H&Laë firm Sh.p.k dhe avokate Eniana Isufi (Cemurati) , anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë , me nr. License nr. 1427, me adresë zyre avokatie në Rrugën e Barrikadave, Godina "Turdiu Center", Tiranë.

PERSON I TRETË:

Arben Vodha, i biri i biri i Hysenit, lindur në Durrës me datën 24.01.1965, banues në Shijak, në momentin e paraqitjes së